

## **BULETINI I IGJK-së Shtator 2006**

Ky Buletin është publikuar për informim sa më të plotë të gjyqësisë së Kosovës rreth veprimtarisë së Institutit Gjyqësor të Kosovës (IGJK). Ky publikim iu është shpërndarë gjyqtarëve dhe prokurorëve në gjithë Kosovën. Buletini mujor i IGJK-së tani përmban artikuj në lidhje me çështjet me interes për gjyqtarët dhe prokurorët që punojnë në Kosovë.

**Osman Tmava**  
gjykatës në Gjykatën Supreme të Kosovës

### **PROCEDURA E SHPALLJES SË PERSONIT TË ZHDUKUR SI I VDEKUR DHE PROCEDURA E TË PROVUARIT TË VDEKJES**

#### **P Ë R M B A J T J A**

Hyrja

#### **I.Procedura e shpalljes të përsoneit të zhdukur si i vdekur**

- Kompetenca e gjykatës
- Subjektët kompetent për fillimin e procedurës
- Akti me të cilin fillohet procedura (propozimi)
- Përmbajtja e propozimit
- Kushtet për shpalljen e personit të zhdukur si i vdekur
- Llogaritja e afateve
- Kush konsiderohet person i zhdukur
- Shqyrtimi paraprak i propozimit
- Hudhja e propozimit
- Shpallja (thirrja publike)
- Publikimi i shpalljes
- Pagesa e shpenzimeve për publikimi ne shpalljes
- Seanca gjyqësore
- Aktvendimi
- Dërgimi i aktvendimit
- Abrogimi i aktvendimit
- Ndryshimi i aktvendimit
- Njoftimi për abrogimin-ndryshimi i aktvendimit

#### **II.Procedura e të provuarit të vdekjes**

Pasojat juridike pas shpalljes të zhdukurit si i vdekur dhe të provuarit e vdekjes personi

#### **III.Procedura e shpalljes së personit të zhdukur si i vdekur dhe procedura e të provuarit e vdekjes të personit me shtetësi të huaj**

#### **IV.Konkluzioni**

#### **V.Literatura**

#### **Veprimtaritë e IGJK-së shtator 2006**

## HYRJE

Ligji për Procedurën Jokontestimore (LPJK), në dispozitën e nenit 57 parashef procedurën për shpalljen e personit të zhdukur si i vdekur dhe procedurën e të provuarit të vdekjes, kur për faktin e vdekjes të një personi nuk ka prova, dokument të paraparë me ligj.

Nga ky përkufizim ligjor del se në këtë procedurë bëhet të provuarit, konstatimi i ekzistimit të fakteve pra i ekzistimit të faktit, vdekjes së një personi. Vdekja përkatësisht lindja e një personi janë procese të natyrës por njëherit janë edhe fakte juridike. Derisa me lindje krijohet një subjektivitet juridik ai me vdekje shuhet.

Në procedurën e shpalljes të personit të zhdukur si i vdekur dhe të provuarit e vdekjes

të një personi konstatohet koha e vdekjes të një personi. Zhdukja e personit bëhet kundër vullnetit të tij apo me vullnetin e tij. Këtë dallim në dispozitën e sipër cekur ligji nuk e bënë shprehimisht. Në këtë procedurë pra personi i zhdukur shpallet si i vdekur dhe provohet vdekja e një personi për të cilin në afatin e caktuar me ligj nuk ka informata se është i gjallë, se në atë afat do të duhej apo do të kishte mundësi të paraqitej përkatësisht se nuk ekziston dokument për konstatimin e vdekjes së një personi. Nga dispozita e sipër cekur ligjore rezultojnë dy situata juridike përkatësisht dy procedura të veçanta dhe ato:

1. Procedura e shpalljes së personit të zhdukur si i vdekur dhe
2. Procedura e të provuarit e vdekjes .

## I. PROCEDURA E SHPALLJES SË PERSONIT TË ZHDUKUR SI I VDEKUR

### Kompetenca e gjykatës.

Për shpalljen e personit të zhdukur si i vdekur kompetente është Gjykata Komunale në rajonin e të cilës personi i zhdukur e ka pasur vendbanimin e përhershëm të fundit por nëse nuk ka pasur vendbanim të përhershëm,

kompetente është gjykata në rajonin të cilës personi i zhdukur ka pasur vendbanimin e përkohshëm të fundit.

Procedurën e zhvillon dhe aktvendimin e merrë gjyqtari i vetëm.

### Subjektët kompetent për fillimin e procedurës.

Procedurën e shpalljes së një personi të zhdukur si i vdekur mund të e iniciojnë:

- a) Çdo person (fizik-juridik) që për këtë ka interes juridik dhe
- b) Prokurori Publik.

## **Akti me të cilin fillohet procedura (propozimi).**

Procedura për shpalljen e personit të zhdukur si i vdekur, fillohet me paraqitjen e

propozimit në gjykatën kompetente nga personi kompetent.

### **Përmbajtja e propozimit.**

Propozimi si akt përkatësisht si parashtrësë duhet të përmbajë sidomos: emrin e gjykatës, emrin dhe mbiemrin e personit për të cilin propozohet të shpallet i vdekur, ditën e lindjes dhe vendbanimin e fundit të përhershëm ose të përkohshëm të atij personi, faktet në të cilat mbështetet propozimi, në çka

konsiston interesi juridik i propozuesit, provat me të cilat konstatohen këto fakte, emrin dhe mbiemrin e propozuesit dhe adresën e tij.

Bashkë me propozimin paraqitet ekstrakti nga libri amzë i të lindurve për personin me të cilin ka të bëjë propozimi.

### **Kushtet për shpalljen e personit të zhdukur si i vdekur.**

LPJK në dispozitën e nenit 57 par.1 parasheh në cilat kushte personi i zhdukur mund të shpallet si i vdekur. Këto kushte janë të natyrës materiale-juridike çka kjo është specifikë e këtij ligji si ligj procedural. Në këtë drejtim si kushte theksohen:

**a)** I vdekur mund të shpallet personi për jetën e të cilit 5 vitet e fundit (para fillimit të procedurës), nuk ka pasur kurrfarë informatash kurse nga lindja e atij personi kanë kaluar 70 vite. Kjo kategori pra i përket personave të moshuar.

**b)** Shpallet për të vdekur edhe personi për jetën e të cilit gjatë 5 viteve të fundit (para fillimit të procedurës) nuk ka pasur kurrfarë informatash ndërsa rrethanat në të cilat është zhdukur bëjnë të besohet se nuk është i gjallë

p.sh. ka qenë shumë i sëmurë kur është lajmëruar, është pa, herën e fundit ose p.sh. të liqeni, lumi janë gjetur rrobat e atij personi ndërsa ai aty është pa për herë të fundit, etj.

**c)** Situatë tjetër është kur personi është zhdukur me rastin e fatkeqësisë-thyerjes së anies, fatkeqësisë në komunikacioni, fatkeqësive si: zjarr, përmytje, tërmet ose ndonjë rrezik tjetër të drejtpërdrejtë ndërsa për jetën atij personi nuk ka pasur kurrfarë informatash 6 muaj pas përfundimit, heqjes së rrezikut.

**d)** I vdekur mund të shpallet edhe personi i zhdukur në luftë përkatësisht lidhur me ngjarjet e luftës kurse për jetën e tij nuk ka kurrfarë informatash 1 vit nga dita e pushimit të armiqësisë.

### **Llogaritja e afateve.**

Sipas kushteve të cekura më lart afatet llogariten ashtu që kushtet sipas nenit 57 par.1 pika a dhe b afati fillon të llogaritet duke filluar prej ditës kur sipas informatave të

fundit, personi i zhdukur pa dyshim ka qenë në jetë. Nëse kjo ditë nuk mund të konstatohet me saktësi, afati llogaritet me mbarimin e muajit përkatësisht të vitit në të cilin personi i

zhdukur sipas informatave të fundit pa dyshim ka qenë i gjallë. Për situatat tjera afati llogaritet nga dita e pushimit të rrezikut i cili ka

kërcënuar jetën e personit përkatësisht pushimi i armiqësisë.

### **Kush konsiderohet person i zhdukur.**

Ligji nuk jep përkufizimin por mund të konkludohet se i zhdukur konsiderohet

a) personi i cili ka munguar nga vendi ku ka jetuar për një kohë të caktuar,

b) kur për një person nuk ka kurrfarë informatash se ku ndodhet

c) kur është e pasigurt se ai preson është gjallë apo i vdekur.

Këto paraqiten si prezumime procedurale sa i përket personit të zhdukur, të cilat duhet të ekzistojnë kumulativisht në kohën kur inicohet procedura gjyqësore.

### **Shqyrtimi paraprak i propozimit.**

Gjykata pasi ta marrë propozimin, në mënyrë të përshtatshme do të vërteton se a janë plotësuar parakushtet (prezumimet) për fillimin e procedurës përkatësisht do të vërteton kompetencën e gjykatës, rregullësin e propozimit, ekzistimin e interesit juridik të propozuesit dhe identitetin e personit të zhdukur.

Nëse në bazë të dhënave nga propozimi ose pas vërtetimit të bërë vlerësohet se janë plotësuar prezumimet procedurale, atëherë personit të zhdukur do t'i caktohet kujdestari dhe për këtë do të njoftohet organi i

kujdestarisë ose gjykata do të thërret organin e kujdestarisë që brenda afatit të caktuar të emëroj kujdestarin për përfaqësim në procedurë.

Kujdestari ka për detyrë të mbledhë të dhëna për zhdukjen ose për jetën e personit të zhdukur dhe ato do t'i prezantojë gjykatës p.sh. merë shënime për personin e zhdukur në lokalitetin ku ai person ka jetuar etj.

Gjykata edhe sipas detyrës zyrtare do të sigurojë dhe do të nxjerrë prova për t'i konstatuar faktet se a ka vdekur personi i zhdukur, kur ka vdekur apo është në jetë.

### **Hudhja e propozimit.**

Gjykata kur konstaton se nuk janë plotësuar prezumimet e sipër cekura procedurale propozimin do ta hudhë.

### **Shpallja (thirrja publike).**

Nëse janë plotësuar prezumimet procedurale gjykata fillon me procedurën ashtu që publikon shpalljen-thirrjen publike.

Shpallja publike përmban:

- rrethanat qenësore të rastit,
- thirrret personi i zhdukur, por

- thirrret edhe çdo person që din diçka për jetën e personit të zhdukur dhe për personin e zhdukur, të njoftojë gjykatën menjëherë, dhe

- gjykata do të bënë të ditur, pra venë në dijeni se me kalimin e afatit prej 3 muajve duke filluar prej ditës së publikimit të shpalljes

në gazetën zyrtare do të vendosë për propozimin.

### **Publikimi i shpalljes.**

Shpallja si edhe u theksua më lart publikohet në gazetën zyrtare por edhe në tabelën e shpalljeve të gjykatës, në vendin ku personi i zhdukur ka vendbanimin përkatësisht

vendqëndrimin dhe në lokalet e bashkësisë lokale ku personi i zhdukur ka vendbanimin përkatësisht vendqëndrimin.

### **Pagesa e shpenzimeve për publikim të shpalljes.**

Në qoftëse propozuesi në bazë të urrdhërit të gjykatës në afatin e caktuar nuk bënë pagesën e shpenzimeve për publikim të shpalljes, gjykata do të konsideron se

propozimi i paraqitur është tërhjekur. Kjo situatë nuk do të ndodhë në rastin kur propozimin e ka paraqitur Prokurori Publik

### **Seanca gjyqësore.**

Gjykata do të cakton seancën nëse më parë vërteton se nga publikimi i shpalljes kanë kaluar 3 muaj, se nuk është paraqitur personi i zhdukur apo nuk ka gjurmë, informata se është i gjallë. Në seancë gjykata do të thërras propozuesin dhe kujdestarin e personit të zhdukur dhe do të nxjerrë provat e nevojshme. Gjykata nëse konstaton se është plotësuar

ndonjë nga kushtet e parapara në nenin 57 të LPJK, ndërsa edhe rezultatet e procedurës së tërësishtme vejnë në dukje, në mënyrë të sigurt se personi i zhdukur nuk është i gjallë, do të pranon propozimin dhe merë aktvendim me të cilin personin e zhdukur do ta shpallë si i vdekur.

### **Aktvendimi.**

Aktvendimi me të cilin pranohet propozimi dhe personi i zhdukur shpallet si i vdekur, duhet të përmbajë: emrin dhe mbiemrin, vendbanimin e përhershëm ose të përkohshëm të fundit të personit të zhdukur, emrin dhe mbiemrin e prindërve të tij, ditën muajin dhe vitin e lindjes, pastaj do të konstatohet dita muaji dhe viti brenda mundësive edhe ora që konsiderohet kohë e vdekjes të presonit të zhdukur.

Si kohë e vdekjes do të konsiderohet dita e cila në bazë të provave të nxjerura konstatohet se personi i zhdukur ka vdekur përkatësisht dita kur personi i zhdukur me siguri nuk ka mbetur gjallë. Nëse kjo ditë nuk mund të vërtetohet do të konsiderohet se vdekja ka ndodhur ditën e parë pas kalimit të afateve të parapara në dispozitën e nenit 57 të LPJK.

### **Dërgimi i aktvendimit.**

Aktvendimi i plotfuqishëm në të cilin shpallet personi i zhdukur si i vdekur i dërgohet:

- nëpunësit të gjendjes civile,
- gjykatës kompetente komunale,

- organi të kujdestarisë,
- shërbimit të kadastrit,dhe
- prokurorit publik kur ai paraqitet si propozues.

### **Abrogimi i aktvendimit.**

Gjykata aktvendimin e plotfuqishëm për shpalljen e personit të zhdukur si i vdekur do ta abrogojë:

a) Nëse personalisht paraqitet në gjykatë personi i zhdukur i shpallur si i vdekur dhe në atë rast gjykata sipas detyrës zyrtare pa zhvilluar procedurë bënë abrogimin e aktvendimit dhe pezullon procedurën.

b) Nëse gjykata në çfarëdo mënyre informohet se personi i zhdukur është i gjallë, sipas detyrës zyrtare do të fillojë procedurën për abrogimin e aktvendimit. Këtë procedurë gjykata do të e zhvillon edhe sipas propozimit të personave të interesuar apo prokurorit publik.

### **Ndryshimi i aktvendimit.**

Në rast se pas marrjes së aktvendimit për shpalljen e personit të zhdukur për të vdekur, kuptohet, merret në dijeni se ai person ka vdekur një ditë tjetër e jo në ditën si është konstatuar në aktvendim atëherë gjykata në

propozim të personit të interesuar i cili ka interes juridik apo në propozim të prokurorit publik do të zhvillojë procedurën dhe sa i përket ditës së vdekjes do të e ndryshojë aktvendimin.

### **Njoftimi për abrogimin-ndryshimin e aktvendimit.**

Pasi të fillojë procedura për abrogimin apo ndryshimin e aktvendimit, gjykata ka detyrim të njoftojë:

- organin kompetent të kujdestarisë,
- gjykatën trashëgimore para të cilës është në zhvillim procedura e shqyrtimit të trashëgimisë të personit të zhdukur.

Në rast se me aktvendimin e plotfuqishëm të gjykatës është shqyrtuar pasuria trashëgimore e personit të zhdukur, ku është përfshirë edhe pasuria e paluajtshme, gjykata do të urdhërojë të bëhet shënim në

librin e tokave-kadastër, për procedurën e filluar për ndryshimin-abrogimin e aktvendimit.

Gjykata edhe kur refuzon propozimin për ndryshim-abrogim të aktvendimit, ka për detyrë të njoftojë organin kompetent të kujdestarisë, gjykatën trashëgimore ku shqyrtohet pasuria e personit të zhdukur dhe shërbimin e kadastrit për të bërë fshirjen e shënimit të bërë lidhur me procedurën e zhvilluar.

## II. Procedura e të provuarit të vdekjes.

Nëse fakti i vdekjes së një personi nuk mund të provohet me anë të dokumentit të paraparë me ligj përkatësisht ekstraktit nga libri amzë i të vdekurve, çdo person i cili ka interes juridik por edhe prokurori publik, mund të paraqesin propozimin që me aktvendim të konstatohet vdekja e atij personi.

Në këtë procedurë në mënyrë adekuate zbatohen dispozitat e procedurës për shpalljen e personit të zhdukur si i vdekur. Megjithatë në këtë procedurë për dallim nga procedura për shpalljen e personit të zhdukur si i vdekur specifike është shpallja-thirrja publike e cila në këtë procedurë jepet në afat jo më të shkurtë se

15 e as më të gjatë se 30 ditë, të cilin afat gjykata e cakton varësisht nga rasti konkret.

Njëherit specifike është edhe fakti se në këtë procedurë propozimi për provimin e vdekjes mund të parashtrahet në gjykatë menjëherë pas vdekjes së personit vdekja e të cilit provohet.

Në aktvendimin e gjykatës me të cilin pranohet propozimi tregohet dita në të cilën personi sipas provave të administruara ka vdekur. Në qoftë se nuk mund të konstatohet pa dyshim dita e vdekjes, si ditë e vdekjes konsiderohet dita për të cilin është konstatuar se i vdekuri nuk e ka përjetuar.

### **Pasojat juridike pas shpalljes së një personi të zhdukur si i vdekur përkatësisht të provuarit e vdekjes së një personi.**

Në procedurat e sipër cekura në fakt bëhet një harmonizim i gjendjes faktike me ato juridike.. Aktvendimi i lëshuar sipas procedurave të sipër cekura ka efekt të njëjtë juridik si vdekje natyrore e një personi. Kjo realizohet me regjistrimin në librin amzë të vdekurve Me vdekjen e një personi pushon edhe subjektiviteti juridik i atij personi dhe në këtë drejtim paraqiten edhe efektet juridike si

p.sh. hapet çështja e trashëgimisë, bëhet shuarja e martesës, pushojnë autorizimet të cilat ai personi i ka dhënë personave të tjerë hapet çështja e drejtave nga baza e sigurimeve, kompensimit të dëmit etj. Në këtë drejtim është me rëndësi të veçantë që në aktvendim të precizohet dita përkatësisht ora e saktë e vdekjes të një personi.

### **Procedura e shpalljes së personit të zhdukur si i vdekur përkatësisht të provuarit e vdekjes të personit me shtetësi të huaj.**

Ligji për zgjedhjen e kolizionit të ligjeve me dispozitat e vendeve të tjera në marrëdhëniet e caktuar në nenin 16 parasheh se për shpalljen e personit të zhdukur si i vdekur kompetente është e drejta e shtetit shtetas i të cilit ka qenë ai person në kohën e zhdukjes. Ky ligj në nenin 78 par.1 parasheh se gjykata e jonë ka kompetencë ekskluzive për shpalljen e

shtetasit tonë të zhdukur si i vdekur, pa marrë parasysh se ku ai ka pasur vendbanimin. Në par.2 të dispozitës të cituar parashihet që gjykata e jonë është kompetente për të provuar vdekjen e shtetasit të huaj apo të personit pa shtetësi, me kusht që ai të ketë vdekur në territorin e shtetit.

### III. Konkluzioni

Si pasojë e luftës në Kosovë, është fakt se janë zhdukur shumë persona. Për shpalljen e këtyre personave të zhdukur si të vdekur në gjykatat e Kosovës janë iniciuar një numër i

vogël i procedurave gjyqësore. Mendoj që do të ishte me interes për familjarët e tyre të inicohen procedurat gjyqësore për hir të realizimit të interesave juridike të tyre

### IV. Literatura:

Ligji për procedurën jokontestimore (Gazeta Zyrtare e KSAK e Kosovës nr.41/1986 datë 24.10.1986).

Ligji për zgjedhjen e kolezionit të ligjeve me dispozitat e vendeve të tjera në marrëdhëniet e caktuara (Gazeta Zyrtare e RSFJ nr.43/1982 datë 23.07.1982).

Dr.Faik Brestovci: E Drejta Procedurale Civile II. Prishtinë 1977

### Veprimtaritë e IGJK-së Shtator 2006

#### Seminar, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Më 04 dhe 05 shtator 2006 IGJK organizoj një trajnim nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rajonin e Prishtinës. Ky ishte një sesion dy-ditor i cili kishte për synim të jap një pasqyrim të detajuar drejt zbatimit të dispozitave të neneve 5 dhe 6 të kësaj Konvente, me qëllim të ngritjes së njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve Kosovar drejt praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Katër trajnues vendor gjyqtar dhe prokuror të cilët janë certifikuar nga Këshilli i Evropës vepruan në cilësinë e trajnuesve në këtë sesion.

#### Trajnim i shkathtësive praktike: Simulimi i gjykimit

Më 07 shtator 2006 IGJK organizoj një simulim praktik të një gjykimi për gjyqtarët

e lëmisë civile nga rajoni i Gjilanit. Për qëllim të këtij simulimi u përzgjedh një rast problematik nga praktika gjyqësore. Pjesëmarrësit diskutuan për problemet e ndërlidhura me procedurën civile në rastet e ngjashme.

#### Tryezë diskutimesh: Konfiskimi, procedura e konfiskimit

Më datën 12 shtator IGJK organizoj një tryezë diskutimesh me temën e lartpërmendur. Qëllimi kryesor i kësaj tryeze ishte që të prezantohen dhe të analizohen problemet e praktikës gjyqësore përmes rasteve nga praktika gjyqësore që ndërlidhen me Konfiskimin, procedurën e konfiskimit etj.

#### Tryeze diskutimesh lidhur me dispozitat e Kodit të procedurës Penale



Më datën 13, 14, 15 Shtator në 2 Ohër të Maqedonisë, Instituti Gjyqësor i Kosovës organizoj një tryeze te diskutimeve rreth zbatimit të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës. Pjesëmarrësit në këtë tryezë diskutuan dhe analizuan praktikën gjyqësore dhe nxorrën disa konkluzione përfundimtare dhe rekomandime me qëllim të qartësimit të dilemave ekzistuese dhe interpretimeve kundërthënëse të dispozitave të këtij kodi.

#### Tryezë diskutimesh për Kodin e Etikës

Më 19 shtator 2006 në kuadër të aktiviteteve trajnuese nëpër rajonet e Kosovës IGJK organizoj një tryezë të diskutimeve lidhur me Kodin e Etikës. Kësaj radhe përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarët dhe prokurorët nga rajoni i Mitrovicës. Ky trajnim kishte për qëllim që të jap një pasqyrim më të detajuar mbi përvojën dhe praktikën, ku pavarësia e gjyqtarëve mund të jetë brengosëse. Trajnimi u përqendrua në pozitën e gjyqtarit si një vendimmarrës personal apo si një vendimmarrës në kolegji.

#### Simulim i gjykimit – lëmia penale

Në vazhden e simulimeve të gjykimeve nga lëmia penale nëpër rajonet e Kosovës më 21 shtator 2006 IGJK organizoj një simulim edhe në rajonin e Prizrenit. Për qëllim të këtij simulimi u përzgjedh një rast konkret nga praktika i cili në vetë ngërthente shumë çështje të ndërlidhura me vështërsitë me të cilat ballafaqohen gjyqtarët dhe prokurorët e rajonit të Prizrenit.

#### Seminar : Hetimi dhe gjykimi i veprave penale të ndërlidhura me korrupsionin

Më 22 shtator 2006 IGJK në bashkëpunim me Këshillin e Evropës realizuan një seminar lidhur me Hetimin dhe gjykimin e veprave penale të ndërlidhura me korrupsionin. Gjatë punës së këtij seminary në cilësi të ekspertëve ndërkombëtar ishin persona me përvojë të gjatë në këtë lëmi të cilët bartën te pjesëmarrësit njohurit e tyre.

#### Seminar për gjyqtarë porotë në rajonin e Pejës

IGJK në bazë të mandatit që ka dhe në kuadër të organizimit të trajnimeve për gjyqtarët porotë neper rajonet e Kosovës kësaj radhe më 26 shtator 2006 organizoj seminarin për gjyqtarët porotë të rajonit të Pejës. Trajnimi u përqendrua në aspektin praktik të zhvillimit të procedurave penale dhe civile përfshirë edhe disa aspekte të Kodit të etikës.

#### Tryezë diskutimesh - Procedura për shpalljen e personit të zhdukur si të vdekur

Më datën 28 shtator 2006 IGJK organizoj një tryezë diskutimesh me temën e lartpërmendur. Duke pasur parasysh situatën e përgjithshme të pas luftës përkitazi me numrin e madh te personave te pagjetur si dhe reflektimin e kësaj çështje në marrëdhëniet pronësore juridike në kuadër të procedurës jashtëkontestimore janë paraparë kushtet që duhet përmbushur me qellim që një person i zhdukur të shpallet si i vdekur. Natyrisht këto dhe çështjet tjera të parapara me dispozita ligjore dhe raste nga praktika gjyqësore parashihet të jenë objekt diskutimi në këtë tryezë.

### **Ngjarjet e ardhshme tetor 2006**

Seminar, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut Grupi përfitues: gjyqtarët dhe prokurorët e rajonit të Gjilanit. IGJK do të organizoj një trajnim nga Konventa

Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rajonin e Gjilanit. Ky do të jetë sesion dy-ditor i cili mëton që të jap një pasqyrim të detajuar drejt zbatimit të dispozitave të neneve 2 dhe

3 të kësaj konvente, me qëllim të ngritjes së njohurive të gjyqtarëve dhe prokurorëve të Kosovës drejt praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Katër trajnues vendor gjyqtar dhe prokuror të cilët janë çertifikuar nga Këshilli i Evropës do të veprojnë në cilësinë e trajnuesve në këtë sesion.

*Data e planifikuar: 02 dhe 03 tetor 2006.*

#### Trajnim i shkathtësive praktike: Simulimi i gjykimit

*Grupi përfitues: Gjyqtarët e lëmisë civile*

IGJK është duke planifikuar një simulim praktik të një gjykimi për gjyqtarët e lëmisë civile nga rajoni i Pejës. Për qëllim të këtij simulimi do të përzgjidhet një rast problematik nga praktika gjyqësore. Pjesëmarrësit do të diskutojnë për problemet e ndërlydhura me procedurën civile në rastet e ngjashme.

*Data e planifikuar: 04 tetor 2006*

#### Tryezë diskutimesh: Parashkrimi i ndjekjes penale

*Grupi përfitues: Gjyqtarët dhe prokurorët*

Qëllimi kryesor i kësaj tryeze është e qe te prezantohen dhe te analizohen problemet e Data e planifikuar: 17 tetor 2006

#### Seminar lidhur me risitë e Ligjit për Familjen

*Grupi përfitues: Gjyqtarët e lëmisë civile*

Temat të cilat do të shtjellohen gjatë punës së seminarit kryesisht do të përqendrohen në çështjet që kanë të bëjnë me risitë në Ligjin për Familjen sidomos ato lidhur me vërtetimin e atësisë, adoptimin, besimin e fëmijëve në ruajtje dhe edukim në rastet e shkurorëzimit, etj. Gjithashtu vëmendje e veçantë do t'i kushtohet edhe vështirësive me të cilat po ballafaqohen gjyqtarët në zbatimin e dispozitave të reja të Ligjit të ri

praktikes gjyqësore përmes rasteve nga praktika që ndërlydhen me çështjet e parashkrimit të ndjekjes penale, parashkrimi i ekzekutimit të dënimeve etj.

*Data e planifikuar: 10 tetor 2006*

#### Tryeze diskutimesh lidhur me ekzekutimin e vendimeve civile

Instituti Gjyqësor i Kosovës (IGJK) është duke planifikuar organizimin e një tryeze të diskutimeve ku ne fokus do të jete çështjet e ekzekutimit të vendimeve civile dhe problemet që hasen në praktikën gjyqësore në këtë drejtim me qëllim të harmonizimit të sajë.

*Data e planifikuar: 12 tetor 2006*

#### Trajnim për gjyqtarët për Kundërvajtje

Gjatë vitit 2006 IGJK do të vazhdoi organizimin e sesioneve të posaçme trajnuese për gjyqtarët për kundërvajtje. Sesioni i katërt trajnues i këtij viti do të përqendrohet në procedurën kundërvajtëse me theks të veçantë në përgjegjësinë kundërvajtëse, bashkëpërgjegjësinë e personave fizik dhe juridik dhe mbledhja e dëshmive gjatë procedurës.

për Familjen në zgjidhjen e rasteve civile nga kjo lëmi.

*Data e planifikuar: 26 tetor 2006*

#### Tryezë diskutimesh – Ankesa- procedura sipas ankesës

*Grupi përfitues: Gjyqtarët dhe Prokurorët*

Qëllimi kryesor i kësaj tryeze është e qe te prezantohen dhe te analizohen arsyet e paraqitjes së ankesës, shkallet e vendosjes në baze të ankesës dhe paraqitja e rasteve konkrete nga praktika gjyqësore ku haset në vështirësi dhe dilema me qëllim të eliminimit të tyre.

*Data e planifikuar: 27 tetor 2006*